

Përmbledhje

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT, gjatë mandatit të kësaj Qeverie, ka vendosur si njërin prej prioriteteve të saja licencimin dhe akreditimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL). Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për themelimin e Komisionit të Akreditimit për Institucionet e Arsimit të Lartë Privat, si dhe ka autorizuar MASHT-in, për funksionalizimin sa më të shpejt të këtij Komisioni. Kështu, MASHT-i, ka kontraktuar Këshillin Britanik për Akreditim që të bëjë një vlerësim të jashtëm të BPrAL, mbi bazën e të cilit MASHT-i do të marrë vendim për licencimin dhe akreditimin e tyre.

Së pari, Qeveria e Kosovës, me vendimin e saj për themelimin e Komisionit për Akreditim, ka bërë shkelje të qartë të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë. Ky ligj, shprehimisht përcakton se është Agjensioni për Akreditim i Kosovës, institucioni i cili mund ta bëjë vlerësimin si dhe akreditimin e BPrAL, dhe jo MASHT-i.

Kuadri ligjor për sa i përket rregullimit të fushës së arsimit të lartë, është i mangët dhe shpeshherë kontradiktor. Ka mospërputhje në mes versionit anglisht dhe atij shqip të Ligjit, në mes Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ (UA) për Licencim, si dhe brenda vetë UA për Licencim. Veç kësaj, mungojnë edhe dy akte nënligjore për sa i përket rregullimit të fushës së akreditimit të kërkuara me Ligjin mbi Arsimin e Lartë. Si rrjedhojë e kësaj, nuk mund të pretendohet se procesi i tanishëm ka të bëjë me akreditimin e BPrAL, por ky proces është rilicencim, licencim, apo shikim i gjendjes që mbretëron në këto institucione, i cili edhe si i tillë është ndikuar politikisht e manipuluar profesionalisht.

Po ashtu, mund të thuhet se metodologjia e përdorur nga ana e MASHT-it për vlerësimin e BPrAL, nuk garanton se do të jetë mjet plotësues për përfundimin e suksesshëm të këtij procesi. Kjo për faktin se të dhënat e dala nga pyetësi i MASHT-it, nuk kanë kritere të qarta të paracaktuara mbi bazën e të cilave këto të dhëna do të mund të krahasoheshin si dhe për shkak se metodologjia nuk i është përshtatur specifikave që ka Kosova për sa i përket deformimeve në zhvillimin e sektorit të arsimit të lartë privat. Pyetësi i MASHT-it, tash për tash mund vetëm ta paraqes gjendjen aktuale që mbretëron tek BPrAL, e përkufizuar më shumë në aspektet teknike që jodomosdoshmërisht tregojnë kualitetin e nxënies. Ky pyetësor nuk mundet assesi të shërbej si mjet adekuat mbi të cilin mund të merren vendime për akreditimin e institucioneve të larta edukative dhe të arrihet rregullimi dhe përmirësimi kualitativ i kësaj fushe.

Veç këtyre shkeljeve, zbrazëtirave ligjore dhe të metave metodologjike, në procesin e licencimit dhe akreditimit të BPrAL, ka pasur edhe ndërhyrje politike, të cilat e komprometojnë tërë procesin. Kështu, duke rrezikuar që e tërë nisma e MASHT-it për licencimin dhe akreditimin e BPrAL të jetë subjektive dhe korruptive. I tërë argumentimi në këtë analizë mbi shkeljen e ligjit dhe anashkalimin e institucioneve të thirrura për të akredituar BPrAL-të merr kuptim të

plotë vetëm kur qitet në kontekstin e politizimit të procesit të akreditimit dhe ndërhyrjeve politike nga partia e ministrit Hoxhaj.

Hyrje

Kjo analizë e shkurtër do të shqyrtojë procesin e licencimit, apo atë çfarë MASHT-i e cilëson akreditim të BPrAL që ajo e ka vënë si njërin prej prioriteteve të saja kryesore gjatë mandatit të kësaj qeverie. Objektivi i përgjithshëm i kësaj analize është të argumentojë se procesi i tanishëm i ndërmarrë nga MASHT-i nuk mund të quhet akreditim i BPrAL, por është një rilicensim, licencim apo shikim i gjendjes që mbretëron në BPrAL në Kosovë. Po ashtu, argumentimi tjetër është se procesi nuk ka qenë i paanshëm duke qenë se ka pasur disa ndërhyrje serioze politike gjatë periudhës së zbatimit të tij nga MASHT-i dhe akterë tjerë politik të partive në pushtet.

Në këtë kontekst, kjo analizë do të tërheqë vërejtjen që këto ndërhyrje e komprometojnë tërë iniciativën e MASHT-it, duke e pasur parasysh mungesën e infrastrukturës adekuate mbi bazën e të cilit një proces i mirëfilltë i rregullimit të fushës të BPrAL do të mund të ndodhte. Në këtë kornizë, kjo analizë kryesisht do të ndalet në tri çështje kryesore:

- 1) baza ligjore mbi licencimin dhe akreditimin e BPrAL;
- 2) nivelin e transparencës të MASHT si dhe;
- 3) metodologjia e përdorur nga MASHT për licencimin dhe akreditimin e BPrAL

Argumentim tjetër i kësaj analize është që baza ligjore mbi licencimin dhe akreditimin e BPrAL nuk ofron një kornizë adekuate për përmbylljen e suksesshme të këtij procesi shumë të rëndësishëm për arsimin kosovar. Ligji mbi Arsimin e Lartë në Kosovë (2002/3)¹ si dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim (14/2003)² nuk ofrojnë kritere dhe procedura të qarta mbi bazën e të cilave procesi i licencimit dhe akreditimit do të mund të përmbyllet me sukses. Të dy këto akte lënë hapësirë të konsiderueshme që i tërë procesi të jetë shumë subjektiv gjatë seleksionimit të BPrAL nga ana e MASHT-it.

Transparenca gjatë tërë procesit të licencimit dhe akreditimit nga ana e MASHT-it, nuk ka qenë e nivelit të duhur. I tërë informacioni që i është plasuar publikut nga MASHT-i ka qenë i bazuar vetëm në Ligjin mbi Arsimin e Lartë, UA për Licencim dhe aprovimin e Këshillit Britanik për Akreditim me detyrë që të bëjë një vlerësim mbi bazën e të cilit BPrAL do të licencoheshin, ri-licencoheshin apo akreditoheshin. Kurse, siç do të tregohet në këtë analizë, baza ligjore në fuqi si dhe metodologjia e përdorur nga MASHT-i nuk ofrojnë një kornizë adekuate brenda së

¹ Ligji mbi Arsimin e Lartë në Kosovë – 2002/3.

<http://www.ks-gov.net/masht/TempFiles/1.RREG.&%20LIGJI%20SHQIP.pdf>

² Udhëzimi Administrativ - 14/2003.

cilës përpjekjet për të vënë rregull në sektorin privat të arsimit të lartë do të mund të përmbylleshin me sukses.

Po ashtu, metodologjia e përdorur nga ana e MASHT-it për procesin e licencimit dhe akreditimit është e mangët dhe nuk ofron mënyrë adekuate plotësuese e cila do të siguronte që procesi të jetë objektiv. Ky qëndrim forcohet kur merret parasysh ambienti në të cilin veprojnë BPrAL, përfshirja e personaliteteve politike në to, si dhe periudha kohore shume e shkurtër e tërë procesit të licencimit dhe akreditimit.

Sfondi i Themelimit të BPrAL: ‘Kërpudhat pas shiut’

Kosova e pas luftës ka parë themelimin e një numri shumë të madh të institucioneve private të arsimit të lartë. Që nga viti 2001, në Kosovë janë të licencuara rreth 30 institucione të tilla, prej të cilave, 24 janë ende aktivë. Përafërsisht në Kosovë janë licencuar 4 institucione private të arsimit të lartë brenda një viti.

Tri prej elementeve kryesore që kanë bërë të mundur themelimin e këtyre institucioneve private kanë qenë mosha e re e popullatës së Kosovës, mungesa e kriterëve rigoroze nga MASHT-i për licencimin e tyre, si dhe mungesa e mbikëqyrjes efektive të BPrAL nga ana e MASHT-it.

Kosova është e populluar me rreth 70% e popullatës nën moshën 30 vjeç kurse rreth 50% e saj e përbëjnë popullata më e vogël se 25 vjeç³. Qartazi ky është një element shumë stimulues për themelimin e institucioneve private të arsimit të lartë. Ky fakt forcohet edhe më shumë kur merret parasysh se Universiteti Publik i Prishtinës deri më tani ka thithur vetëm 6,300 student potencial⁴ nga mesatarisht 24,000 prej tyre që mbarojnë shkollat e mesme në tërë Kosovën⁵.

Një aspekt tjetër që ka bërë të mundur krijimin e këtyre institucioneve kanë qenë mungesa e vullnetit nga ana e MASHT-it që të krijojë kriterë të qarta dhe rigoroze. Në mandatin e kaluar është lejuar themelimi i institucioneve private të arsimit të lartë thuajse pa kurrfarë kriterë të qarta mbi bazën e të cilave BPrAL do të licencoheshin dhe akreditoheshin. Ajo ka licencuar 30 BPrAL pa qartësuar procedurat paraprake që duhet ndjekur për sa i përket licencimit dhe akreditimit. Me një fjalë, në këtë fushë nuk ka pasur kurrfarë mbisundimi të ligjit, pushteti është manipuluar skajshmërisht dhe ka pasur dyshime të bazuara se kjo fushë është mbizotëruar nga korrupsioni dhe politizimi.

³ Enti i Statistikave të Kosovës - www.ks-gov.net/ESK/

⁴ MASHT-i këtë vit ka vendosur ta rrisë numrin e studentëve në Universitetin e Prishtinës në 11.010.

⁵ “Pasqyrë e Arsimit të Lartë në Kosovë – Instituti GAP – Maj 2008.

http://www.gapinstitute.org/gap/docs/pdf/Pasqyre_e_Arsimit_të_Lartë_në_Kosovë.pdf

Veç kësaj, Ministria e Arsimit, deri më tani, asnjëherë nuk ka inspektuar asnjë prej BPrAL rreth cilësisë së ofruar në këto institucione. Deri në fillim të vitit 2008, nuk është themeluar Agjensioni i Akreditimit të Kosovës (AAK), i cili është i thirrur, ndër të tjera, të bëjë vlerësimin e kualitetit të BPrAL. Kështu mungesa e hapësirës absorbuese të Universitetit Publik të Prishtinës, e kritereve jo të qarta për licencimit dhe akreditim të BPrAL, si dhe mungesa e mbikëqyrjes së tyre, ka bërë që sot shumica e institucioneve private të arsimit të lartë të jenë një biznes fitimprurës. Kjo është shfrytëzuar maksimalisht nga njerëz që kishin kapital, të cilët shpesh e barazuan hapjen e shkollës me hapjen e një pompe benzine apo një pishine larjeje, ku biznesi i arsimit të lartë vetëm gjatë vitit 2007 ka gjeneruar një shumë prej 26.5 milion euro⁶.

Baza Ligjore: - E mangët dhe konfuze -

Ligji mbi Arsimin e Lartë në Kosovë - (2002/3) - për herë të parë që nga paslufta ka vendosur bazën ligjore për themelimin e BPrAL. Përkundër kësaj përpjekjeje për të vendosur një kornizë ligjore e cila do të ofronte një bazë të mirëfilltë mbi të cilën do të rregullohej themelimi dhe funksionimi i BPrAL, ky ligj nuk ofron kritere dhe procedura të qarta për operimin e BPrAL.

Së pari, për sa i përket fushës së akreditimit të BPrAL, nuk është plotësuar i gjithë kuadri nënligjor i kërkuar me Ligjin mbi Arsimin e Lartë. Deri më tani, Ministria e Arsimit ka shpallur dy akte nënligjore, atë për Licencimin e BPrAL (UA 14/2003), si dhe atë për themelimin e Agjencinë për Akreditim të Kosovës (UA 11/2004). Në këtë aspekt, Ministria ende nuk ka nxjerr edhe dy Udhëzime Administrative shumë të nevojshme për rregullimin e akreditimit të BPrAL. Sipas Ligjit (2002/3), Ministria e Arsimit duhet të shpallë edhe dy Udhëzime Administrative, atë mbi procedurat e akreditimit për herë të parë⁷, si dhe atë mbi vlerësimin e cilësisë⁸. Pra, po të bëhej procesi i akreditimit pas nxjerrjes së këtyre UA-ve, do të kishte shumë më pak mundësi manipulimi e ndikimi dhe sigurisht që si rezultat do të kishim një proces shumë më transparent që do të krijonte parakushte për BPrAL më kualitativ. Fakti që kjo nuk ka ndodhur, por ka filluar procesi i "akreditimit" lë vend për dyshime se është kërkuar ambient për manipulim.

Së dyti, megjithëse ligji bën dallimin e qartë në mes nocionit Akreditim⁹ dhe Licencim¹⁰, ka një mospërputhje mes versionit shqip dhe atij anglisht të ligjit për sa i përket proceduarve që

⁶ Po aty

⁷ **Neni 11.2** Procedura për akreditimin për herë të parë përcaktohet në një udhëzues administrative të cilin e jep Ministria sipas rekomandimit të AAK-së.

⁸ **Neni 11.11** Ministria, mbi bazën e rekomandimit të AAK-së, nxjerr një udhëzues administrative për kryerjen e vlerësimeve mbi cilësinë. Rezultatet e vlerësimeve të cilësisë bëhen publike.

⁹ **Neni 1 – Përkufizime: "Akreditim"**, do të thotë njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij plotësojnë standardet e cilësisë përgjithësisht të pranuar dhe se kualifikimet e tij i japin bartësve të tyre (në përputhje me ligjin përkatës) një numër të drejtash, p.sh. mundësi për të ndjekur një nivel të mëtejshëm arsimor, për vende pune specifike, për të përdorur një titull.

¹⁰ **Neni 10 - Licencimi i bartësve të institucioneve:** Çdo bartës i arsimit të lartë në Kosovë duhet të ketë një **licencë për të kryer punën e tij**. Licenca lëshohet nga Ministria sipas dispozitave të këtij Ligji dhe dokumenteve plotësuese të nxjerra mbi bazën e saj.

duhet ndjekur BPrAL në lidhje me licencimin dhe akreditimin e tyre. Edhe pse në Ligj shprehimisht ceket se licencimi i paraprinë akreditimit¹¹, në versionin shqip të Ligjit¹² krijohet përshtypja që BPrAL së pari duhet të akreditohen e pastaj të licencohen. Në versionin anglisht të Ligjit¹³ ndodhë e kundërta. Në këtë kontekst, ky gabim në përkthim është bartur edhe në UA për Licencim 14/2003¹⁴.

Për veç kësaj, ka mospërputhje në mes të Ligjit dhe UA si dhe UA në vetvete për sa i përket institucionit i cili është i thirrur të bëjë akreditimin e BPrAL. Përderisa me ligj në mënyrë të qartë autorizohet AAK të bëjë akreditimin¹⁵, me UA kjo përgjegjësi është e ngatërruar. Në UA neni 5.1. thuhet: Secili BPrAL, në bazë të Ligjit, mund të bëjë kërkesë për të marrë licencë dhe akreditim në MASHT. Ndërsa, nenet 7.1 dhe 7.5 të këtij UA e thonë pikërisht të kundërtën, pra që ky proces duhet të bëhet në AAK. Në këtë kontekst, dihet që në rast të konflikteve, aktet ligjore kanë epërsi ndaj atyre nënligjore. Aktet nënligjore si UA-të, janë vetëm mekanizëm lehtësues për zbatimin sa më të mirë të ligjeve dhe në asnjë moment nuk mund të dominojnë mbi ligjin. Kështu, pyetjeve se kur dhe nga kush bëhet akreditimi i BPrAL, mund t’iu përgjigjemi se bazuar në Ligjin mbi Arsimin e Lartë, licencimi si akt ndodhë i pari në krahasim me akreditimin si proces. Ndërsa, është AAK si institucion i pavarur që e bën akreditimin, kurse MASHT-i, bën licencimin e BPrAL.

Së treti, as Ligji 2002/03, e as UA 14/2003 nuk ofrojnë kriteret të qarta për sa i përket themelimit dhe akreditimit të BPrAL. Si në Ligj po ashtu edhe në UA për Licencim ofrohen disa kriteret dhe kushte të përgjithshme që ligjërisht mundësojnë vetëm licencimin e BPrAL, por jo edhe akreditimin e tyre. Janë vetëm dy kriteret konkrete për sa i përket themelimit të Fakulteteve dhe Universiteteve. I pari thotë se fakulteti duhet t’i ketë 600 studentë¹⁶, ndërsa universitetet mund të quhet ai institucion i cili ka së paku 5 Fakultete, me 3000 studentë¹⁷. Në këtë kuadër, askund nuk ceket qartazi se një institucion edukativ i një lloji të caktuar (Universitet, Fakultet, Institut, etj) duhet të ketë këtë numër të caktuar të mësimdhënësve me

¹¹ **Neni 11.1** Bartësit publikë të licencuar të arsimit të lartë u nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë nga AAK, në përputhje me udhëzimin administrativ i cili do të lëshohet Ministria. Bartësit privatë të licencuara të arsimit të lartë, u nënshtrohen procedurave të tilla në mënyrë periodike ose sipas kërkesës së veçantë të Ministrisë.

Neni 11.7 Nëse dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit atëherë i hiqet licenca. Kundër heqjes së licencës mund të ankohet pranë një gjykate të juridiksionit kompetentë.

¹² **Neni 22.6** Një bartës privat i arsimit të lartë, i licencuar për të operuar në Kosovë, **nuk mund të shpallë aktivitetin**, nëse nuk është akredituar në Kosovë, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Ligj dhe udhëzimeve administrative të nxjerra në bazë të tij.

¹³ **Neni 22.6** A private provider of higher education licensed to operate in Kosovo **may not advertise** itself as ‘accredited’ unless accredited in Kosovo under the procedures set out in the present law and subsidiary instruments issued under it.

¹⁴ **Neni 7.1** Licencimi i BPrAL do të mund të bëhet vetëm mbi bazë të vendimit të AAK për akreditimin e Programeve të BPrAL të caktuar. **Neni 7.5** MASHT-i merr vendim për dhënien e Licencës mbi bazë të vendimit të AAK për akreditimin e programeve të BPrAL dhe të rekomandimeve të ndaj për MASHT-in lidhur me të.

¹⁵ **Neni 11.2** Një bartës i arsimit të lartë që kërkon akreditim për herë të parë bën një kërkesë pranë AAK të paktën një vit përpara datës së parashikuar për marrjen e akreditimit.; **11.5** Certifikatat e akreditimit lëshohen nga AAK-ja.

¹⁶ UA 14/2003 - Neni 8.1.2.

¹⁷ Ligji 2003/14 – Neni 8.2 dhe UA Neni 8.1.2.

tituj të ndryshëm (Doktoraturë, Master, prof. Asistent etj.) për një program të caktuar akademik, numrin e përhershëm të personelit dhe ngarkesën e mësimdhënies që duhet ta mbuloj për një program akademik. Po ashtu, nuk qartësohet relacioni studentë-profesorë, studentë-hapësira të mësimdhënies dhe punës shkencore, programet akademike (kurrikulat) në relacion me institucionin në fjalë etj.

Shihet qartazi që baza ligjore për sa i përket proceduarve, institucioneve dhe kritereve për licencim dhe akreditim të BPrAL nuk janë të qarta dhe nuk ofrojnë një kuadër adekuat për sa i përket rregullimit të fushës së arsimit të lartë privat. Ndërsa qartësimi i proceduarve, institucioneve dhe kritereve që janë më se të domosdoshme për licencimin dhe akreditimin e BPrAL janë kushte esenciale mbi të cilat vendoset rregull dhe kualitet në fushën e arsimit të lartë. Në të kundërtën, të gjitha përpjekjet për licencim dhe akreditim të BPrAL mund të jenë shumë subjektive nga ana e MASHT-it, dhe të paktën për nga aspekti profesional, të korruptuara dhe të politizuara.

Mungesa e Transparencës:

- Shkelja e Ligjit nga ana e Qeverisë -

Qeveria e Kosovës më 30 Janar 2008 ka vendosur për themelimin e 'Komisionit të Akreditimit për Institucionet e Arsimit të Lartë Privat'¹⁸. Qeveria me këtë akt ka vendosur që anëtarët e këtij komisioni të jenë ekspertë nga universitete ndërkombëtare si dhe ka obliguar Ministrin e Arsimit për funksionalizimin sa më të shpejtë të këtij komisioni. Kështu, Ministria e Arsimit ka kontraktuar Këshillin Britanik për Akreditim që të bëjë një vlerësimin mbi BPrAL mbi bazën e të cilit MASHT-i do të marrë vendim për licencimin dhe akreditimin. Deri më tani, as Qeveria e as Ministria e Arsimit, në praktikë, nuk kanë qartësuar dallimin në mes të licencimit dhe akreditimit duke krijuar iluzion tek studentët se me marrjen e licencës nga BPrAL i gjithë procesi i rregullimit të kësaj fushe është rrumbullaksuar. Ndërsa në realitet, pa akreditim të BPrAL nuk mund të pretendohet se është vendosur rregull në arsimin e lartë privat¹⁹.

Në një prononcim për media, kryeministri i Kosovës pat deklaruar se themelimi i këtij komisioni është bërë me qëllim që t'i "iket konfliktit të interesit". Me gjithë se në shikim të parë kjo iniciativë e kryeministrit dhe e MASHT-it duket me vend, me aktin e themelimit të Komisionit për Akreditim, Qeveria e Kosovës ka thyer Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, i cili qartëson se e drejta për ta bërë akreditimin në Kosovë i takon Agjensisë së Akreditimit të Kosovës e jo MASHT-it. Qeveria e Kosovës nuk është institucioni i cili mund të ndryshojë ligjet sipas përshtatshmërisë së saj, por është Parlamenti ai i cili rezervon të drejtën për ndryshim

¹⁸ <http://www.ks-gov.net/pm/LinkClick.aspx?fileticket=DoSzs43zbL0%3d&tabid=57&mid=370>

¹⁹ Shih Neni 1 i Ligji mbi Arsimin e Lartë në Kosovë – Përkufizime: "Akreditim".

apo amandamentim të ligjeve. Dhe këtu, Qeveria, gjegjësisht Ministria e Arsimit, kanë bërë shkelje ligjore me rastin e kontraktimit të Këshillit Britanik për Akreditim për të bërë vlerësimin e BPrAL në Kosovë mbi të cilin ata do të akreditoreshin. Me ligj saktësohet qartazi që e drejta për akreditim i takon AAK-së, ndërsa për licencim Ministrisë së Arsimit.

Në anën tjetër, Këshilli Britanik për Akreditim (KBA)²⁰ është institucion i cili është i thirrur që të bëjë akreditim e Kolegjeve, të cila tek ne, janë ekuivalent të Fakulteteve. Kurse deri më tani në Ministrinë e Arsimit kanë aplikuar për licencim dhe akreditim institucione me emërime të ndryshme si Universitete, Kolegje Universitare, Akademi, Fakultete, Institute, etj. Për më shumë, KBA që nga viti 2000 ka themeluar sistem të akreditimit ndërkombëtarë për Kolegje jashtë Britanisë së Madhe por *‘të cilat punojnë në bashkëveprim formal me trupin britanik për dhënien e vendimeve në fushën e edukimit të lartë’*. Kjo nënkupton që Kolegjet *‘ofrojnë të gjitha apo pjesë të titujve të programeve, apo Diplomë të Lartë Kombëtare’*²¹. Në këtë kontekst, KBA nuk ka bazë ligjore për të kryer procesin e vlerësimit mbi të cilin MASHt-i do të merrte vendim për akreditim, por as nuk ka mandat që të akreditojë institucione tjera jashtë Kolegjeve të cilat i përmbushin kushtet e cekura më lart.

- Mungesa e kriterëve dhe procedurave të qarta për akreditim -

Në disa prononcime për media, ministri i arsimit, Enver Hoxhaj, ka insistuar që asnjë Institucion i Lartë Arsimor nuk do të marrë licencë po qe se nuk e ka kaluar fazën e akreditimit²². Procesi i akreditimit të institucioneve, përveç se kërkon më shumë kohë (6 -12 muaj) e ku KBA ka pasur në dispozicion vetëm 40 ditë (19 maj – 30 qershor) obligon edhe kriterë të qarta mbi të cilat vendimi për akreditim të institucioneve arsimore mund të merret. Në këtë kontekst, siç është parë në këtë analizë, mungojnë Udhëzimet Administrative për akreditim dhe vlerësim të cilësisë, të kërkuara me Ligjin mbi Arsimin e Lartë. Kështu, pa një udhëzim administrativ i cili definon kriteret bazike që Institucionet e Larta të Arsimit duhet t’i plotësojnë, dhe pa definuar procedurat e vlerësimit të cilësisë, nuk mund të merret asnjë vendim mbi akreditimin. Së dyti, procesi i akreditimit të BPrAL, si akt final, kërkon domosdoshmërisht një lloj testi i cili i ngjason atij të maturës shtetërore varësisht prej programeve akademike të ofruara nga BPrAL. Së treti, ministri i Arsimit gabon kur insiston që BPrAL duhet së pari të akreditohej e vetëm më pastaj të licencohen. Licencimi sipas Ligjit, nënkupton leje pune²³ për një subjekt të caktuar, që do të thotë që subjekti në fjalë duhet t’i plotësojë disa kriterë minimale. Akreditimi, sipas ligjit, ka të bëjë me vlerësimin e standardeve të cilësisë së një Institucioni të Arsimit të Lartë dhe të

²⁰ <http://www.the-bac.org/>

²¹ <http://www.the-bac.org/accreditation/international/index.html>

²² Shih Gazetat Ditore 30, Maj 2008. “Ato Institucione që nuk kanë akreditim nuk kanë as Licencë”, ministri Hoxhaj. Po ashtu Koha Ditore 29, Qershor 2008. “Ligji parasheh që asnjë institucion nuk mund të licencohet nëse nuk e ka kaluar një fazë të rëndësishme të saj, të cilës ne i themi akreditim”.

²³ Ligji mbi Arsimin e Lartë, Neni 1 – Përkufizime: “Akreditim”.

Programeve të tij²⁴. Ky qëndrim i ministrit edhe mund të jetë rrjedhojë e keqinterpretimit të ligjit, të shpjeguar më lart. Mirëpo, versioni anglisht i ligjit thekson qartazi që, së pari ndodhë licencimi, e vetëm më pastaj akreditimi. Ky konstatim forcohet edhe nga aspekti logjik i rrjedhës së procesit të licencimit dhe akreditimit, sepse në praktikë, nuk mund të ndodhë vlerësimi i cilësisë së një institucioni dhe programeve të tij pa një leje pune paraprake. Si mund të vlerësohet cilësia e një ‘produkti’ nëse ai institucion nuk ka paraprakisht leje pune për të funksionuar?

Si përfundim, rëndësia e tërë këtij procesi duhet të fokusohet në akreditimin e institucioneve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të barazohet licencimi me akreditimin. Një mashtrim i tillë ka shkaktuar konfuzion dhe uljen e standardeve në fushën e arsimit të lartë, të cilin më së shumti sot e vuajnë studentët kosovarë të cilët paguajnë për shkollimin e tyre cilësorë.

- Metodologjia e përdorur nga ana e MASHT-it -

Metodologjia që MASHT-it ka përdorur për vlerësimin e BPrAL, assesi nuk ofron mënyrë adekuate mbi të cilat mund të merret vendim për akreditimin e këtyre institucioneve. Kjo, për faktin që të dhënat e nxjerra nga pyetësi, që MASHT-i u ka dërguar BPrAL, nuk kanë kriterë paraprake të përcaktuara qartazi mbi të cilat këto të dhëna do të mund të krahasoheshin dhe kështu të nxirrej një vlerësim rreth përmbushjes së obligimeve nga ana e BPrAL. Nga ky pyetësor, assesi nuk mund të nxirren të dhëna mbi gjendjen ekzistuese në BPrAL, dhe kështu nuk mund të merret vendim për akreditim pa kriterë dhe kushte paraprake, duke qenë se nuk adresohet aspekti i kualitetit të studimit dhe të nxënies. Akreditimi do të mund të bëhej vetëm kur ministria e Arsimit paraprakisht nxjerr Udhëzimet Administrative për akreditim dhe vlerësim të cilësisë dhe mbi bazat e tyre merr vendim rreth institucioneve dhe programeve që BPrAL ofrojnë. Mbi të dhënat e nxjerra nga ky pyetësor, MASHT-i, mund të marrë vendim për licencimin e BPrAL, gjë që edhe është kompetencë e këtij institucioni, por kurrësi për akreditimin e tyre. Me këtë metodologji, praktikisht, mundësitë për subjektivizëm në vlerësim janë të mëdha. Meqë, të dhënat e nxjerra nga pyetësi, nuk kanë mundësi të verifikimit të rezultatit të këtyre institucioneve, praktikisht mundësia për improvizime nga ana e pronarëve të këtyre institucioneve por edhe nga vetë politika lihet e hapur. Kjo bën që të ngrihen shumë pikëpyetje rreth mënyrës së ‘akreditimit’ të BPrAL nga MASHT-i.

Veç kësaj, MASHT-i ka gabuar që në emër të pavarësisë profesionale ka anashkaluar plotësisht stafin vendor dhe AAK gjatë tërë këtij procesi të licencimit dhe ‘akreditimit’ të BPrAL. Në këtë formë është krijuar një rreth i mbyllur dhe një monopolizim i procesit nga ana e të të përzgjedhurve të ministrit të arsimit dhe vetë ministrit. Përfshirja e stafit vendor në këtë

²⁴ Po aty, Neni 10 - Licencimi i bartësve të institucioneve.

proces, vetëm do të ndihmonte në ngritjen e kapaciteteve vendore për sa i përket aftësisë profesionale të tij dhe do të bënte që ky proces të ishte vërtetë akreditim e jo farsë.

- Ndërhyrjet politike në procesin e Licencimit dhe Akreditimit -

I tërë argumentimi në këtë analizë mbi shkeljen e ligjit dhe anashkalimin e institucioneve të thirrura për të akredituar BPrAL-të merr kuptim të plotë vetëm kur qitet në kontekstin e politizimit të procesit të akreditimit dhe ndërhyrjeve politike nga partia e ministrit Hoxhaj. Gjatë tërë këtij procesi kanë ndodhur një numër i ndërhyrjeve politike të cilat e komprometojnë gjithë procesin e licencimit dhe akreditimit.

Një ndër ndërhyrjet e para dhe që aspak nuk e ka fshehur përkrahjen politike për një universitet privat ka qenë prononcimi i Bajram Rexhepit, nënkryetar i PDK-së në lokalet e Universitetit AAB se ky Institucion është ndër të parët që duhet të licencohet dhe akreditohet. Dhe kjo nuk ka qenë përkrahja e vetme që ka ardhur për këtë institucion, vendosja në pozitën e lartë në hierarkinë e Universitetit AAB dhe të mësimdhënësës e gruas së ministrit Hoxhaj paraqet një ndërhyrje tjetër politike. Kjo poashtu paraqet një konflikt të qartë interesi, pasi që ministria praktikisht ka marrë punën e Agjensionit të Akreditimit dhe do të marrë vendim final. Duket se AAB e ka të siguruar “akreditimin” pasi që përveç ndërhyrjeve të mësipërme, Ramiz Kelmendi, shkola e gazetarisë e të cilit është shkrimi përbrenda AAB-së, ka pranuar një mirënjohje në lokalet e Universitetit AAB, nga zv. ministrja e kulturës.

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes MASHT-it dhe Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK) për të filluar vlerësimin e shpenzimeve për kompjuterizimin e shkollave në Kosovë, përveç që paraqet një favorizim të këtij universiteti dhe njohje implicite e cilësisë së tij akademike, faktikisht e përjashton nga nevoja për t’iu nënshtruar akreditimit pasi i besohet një vlerësim për të cilin presupozohet se AUK është i përgatitur ta kryejë, është po ashtu edhe një konflikt i pastër interesi pasi kjo bëhet mu para ‘akreditimit’ të BPrAL.

Prezenca e ministrit Ahmet Shala dhe ministres Justina Pula në 13 vjetorin e Institutit Riinvest paraqet po ashtu një ndërhyrje politike me mesazhin se ky Institut e ka përkrahjen tonë jo vetëm si profesorë të UP-së, dmth kolegë në Fakultetin e Ekonomisë me disa udhëheqës të këtij Instituti, por edhe si ministra të qeverisë e cila ka marrë përsipër licencimin dhe akreditimin e arsimit të lartë në Kosovë.

Rektori, zv. Rektori si dhe një numër i mësimdhënësve të Kolegjit Universitar Victory janë anëtarë të Partisë Demokratike të Kosovës dhe disa prej tyre kanë qenë edhe kandidat në zgjedhjet e kaluara. Ndërsa, mosdeklarimi i qartë i ministrit të arsimit rreth pezullimit të

aktivitete të tij si mësimdhënës në Institucionet Private të Arsimit, përveç në rastin e UP-së, paraqet konfliktin më të ashpër të interesit në tërë procesin e licencimit dhe akreditimit të institucioneve të larta të arsimit.

Këto ndërhyrje politike dhe konflikte interesi, mungesa e kuadrit të plotë ligjor dhe kriterëve të qarta për licencim dhe akreditim, shkeljes ligjore nga qeveria me rastin e themelimit të Komisionit të Akreditimit, metodologjia e mangët dhe koha e pakët, lënë hapësirë që i tërë procesi i “akreditimit”, të jetë subjektiv nga ana e MASHT-it, dhe përfundimisht i korruptuar në licencimin dhe akreditimin e BPrAL. Ky fakt, forcohet edhe më shumë kur kihet para sysh se MASHT-i, deri më tani, asnjëherë nuk ka reaguar rreth këtyre ndërhyrjeve që iu kanë bërë procesit të licencimit dhe akreditimit të BPrAL. Paqartësitë dhe dyshimet për politizim dhe manipulim në akreditim shtohen edhe më kur kihet parasysht konflikti mes ministrit Hoxhaj dhe zvkryeministrit Kuçi rreth asaj se ku do të merret vendimi final mbi akreditimin e BPrAL, në MASHT apo Qeveri.

Përmbyllje

Gjatë tërë kësaj analize, është argumentuar se procesi i “akreditimit” të BPrAL ka qenë i përcjellur me monopol, njëanshmëri, ndërhyrje politike, manipulime, konflikte interesi dhe mundësi të mëdha të korrupsionit.

Procesi i tanishëm i ndërmarrë nga ana e MASHT-it nuk mund të quhet akreditim, por ky proces është rilicencim, licencim apo vlerësim i gjendjes që mbretëron në BPrAL. Ky përfundim është bazuar në kuadrin ligjor në fuqi i cili edhe ashtu është i mangët për sa i përket rrumbullakimit të tij me akte nënligjore, por edhe kontradiktave që gjenden në të, dhe në Udhëzimin Administrativ për licencim. Veç kësaj, kjo analizë ka argumentuar që vendimi i qeverisë për themelimin e Komisionit për Akreditim nuk ka bazë ligjore, sepse sipas ligjit në fuqi, procesi i akreditimit është ekskluzivitet i AAK. Për më shumë, Këshilli Britanik për Akreditim nuk ka mandat që të akreditojë institucione tjera përveç Kolegjeve, dhe atë, vetëm nëse ato janë në marrëveshje formale me të.

Kjo analizë po ashtu ka treguar që metodologjia e përdorur nga ana e MASHT-it, nuk ofron metodë plotësuese mbi të cilën do të ndodhte akreditimi i BPrAL. Kjo për faktin që të dhënat e nxjerra nga pyetësi nuk kanë ku të bazohen në mungesë të kriterëve të qarta të paracaktuara.

Në fund, kjo analizë ka argumentuar se ndërhyrjet e ndryshme që i janë bërë procesit të licencimit dhe akreditimit të BPrAL, e komprometojnë tërë nismën e MASHT-it. Po qe se Ministria e Arsimit vendosë që t'i akreditojë BPrAL-të, ajo me këtë akt, do të legalizojë institucione të cilave nuk u dihet cilësia dhe kështu do të marrë përgjegjësi direkte për pasojat

që dalin nga ky vendim. Kjo ngre dyshime rreth sinqeritetit të nismës së MASHT-it dhe Qeverisë për të akredituar institucionet e arsimit të lartë në mënyrën që siguron cilësi dhe rregull në një fushë kaotike, por jashtëzakonisht fitimprurëse.

Rekomandime:

MASHT-i, duhet që urgjentisht të deklarohet se procesi i tanishëm nuk ka të bëjë me akreditimin e BPrAL, por ky proces është rilicencim, licencim apo vlerësim i gjendjes që mbretëron në këto institucione. MASHT-i, po ashtu, duhet t'ia bëjë të qartë opinionit publik dallimin në mes të nocionit licencimit dhe akreditimit të BPrAL, dhe pasojat që derivojnë nga mungesa e akreditimit të këtyre institucioneve. Veç kësaj, MASHT-i, duhet të deklarohet shprehimisht kundër ndërhyrjeve që iu kanë bërë procesit të licencimit dhe 'akreditimit' të BPrAL.

MASHT-ti, duhet po ashtu, që ta qartësojë dhe plotësojë kuadrin ligjor me aktet nën ligjore të kërkuara me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, dhe kështu të sqarojë kriteret dhe procedurat që BPrAL duhet t'i përmbushin përpara se të akreditohen.

Për më shumë, MASHT-i, duhet të bëjë përpjekje që sa më parë ta funksionalizojë Agjensionin për Akreditim të Kosovës, duke ndihmuar me trajnimin e stafit vendor, për sa i përket proceseve të licencimit dhe akreditimit të institucioneve të larta arsimore dhe jo ta injorojë tërësisht këtë institucion. Vlerësimi i punës së këtyre institucioneve nuk mbaron me kaq, por do të ketë nevojë një vlerësim të vazhdueshëm të tyre, prandaj AAK do duhej të krijonte kapacitete dhe pavarësi në mënyrë që të jetë një garancë e një qëndrueshmërie në vlerësimin edhe përtej këtij procesi që po ndodhë aktualisht.

Po ashtu, Qeveria e Kosovës, duhet që ta pezullojë vendimin e saj për themelimin e Komisionit të Akreditimit për Institucionet e Arsimit të Lartë Privat në mungesë të bazës ligjore dhe të lejojë që AAK të kryej punën e saj sipas Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë. Në të kundërtën, vendimi i saj si dhe i MASHT-it, do të paraqesin shkelje të qartë ligjore.